



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtruesa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 175 /2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtruesa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Vlastimir Dimić kryesues, Hasan Shala dhe Ferit Osmanji anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Kaçanik, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Kaçanik, për shkak të vendosjes së posterit në objekt publik, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Kaçanikut, në seancën e panelit të mbajtur me 18.06.2012, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV).

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 14.06.2012, nga subjekti politik LVV, me të cilën pretendohet se me datën 14 Qershor 2012, rreth orës 16:15 në Kaçanik, në rrugën “Agim Bajrami”, në hyrje të Shtëpisë së Mallrave “Sharr”, në Çarshi, militantë të subjektit politik të LDK-së, kanë vendosur posterë të kandidatit të tyre për kryetar të komunës së Kaçanikut Sahit Bela. Me këtë rast parashtruesi i ankesës konsideron se subjekti politik LDK ka bërë shkelje të Rregullës Zgjedhore Nr.11/2009 të *Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, neni 3 paragrafi 1 pika (b), si dhe neni 33 paragrafi 1 pika (b), i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP)*.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur disa fotografi si dëshmi.

PZAP-i, e informoi subjektin politik LDK në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 15.06.2012, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 16.06.2012, në ora 12:00. Sipas afatit të caktuar në shkresën Nr.175/2, PZAP-i, pranoi përgjigje në ankesë nga subjekti politik LDK, brenda afatit të caktuar në të cilën theksohet se: Pohimi i subjektit politik LVV, se subjekti politik LDK, ka vendosur posterë të kandidatit për kryetar në objekte publike, respektivisht në shtëpinë e mallrave, është i paqendrueshëm, për faktin se posteri nuk është vendosur në mure publike por në objekt privat, respektivisht në objektin, i cili është me qira nga personi fizik, poashtu subjekti politik LDK në përgjigjen e tij thekson se kjo mund të

konstatohet nga fotoja, ku sipas tij shihet emërtimi i firmës i cili e ka me qira , si dhe është bërë me pëlqimin e shfrytëzuesit të këtij lokalit, thuhet në përgjigjen të ankeses nga subjektit politik LDK.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Me ankesën e parashtruar nga subjekti politik LVV, pretendohet se militantë të subjektit politik LDK, kanë vendosur posterin e kandidatit për kryetarë komune të Kaçanikut, në objekt publik. PZAP-i gjeti se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë ngase provat e bashkangjitura në ankesë nuk janë dëshmi të mjaftueshme, për të vërtetuar pretendimet ankimore, pasi që nga fotografia që gjendet në shkresat e lëndës nuk mund të identifikohet objekti për të cilin pretendohet se është objekt publik apo për të cilën pretendohet se është Shtëpia e mallrave “Sharr”, pasi që nuk ka kurrfarë mbishkrimi që do të vërtetonte se bëhet fjalë për objekt publik. Prandaj një pretendim i tillë i ankesës u vlerësua si i pabazë, dhe në kuptim të nenit 115.1 lidhur me 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshire është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

A nr. 175/2012 më datën 18.06.2012.

